



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesuese e Senatit

Prof.asoc.dr. Merita Shala

Nr. Prot. 54 Dt 05.01.2024

Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 04.01.2024, mori:

VENDIM

- I. Anulohet vendimi i Senatit me nr.prot.2993 dt.21.12.2023 për rishpalljen e konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë për vitin akademik 2023/2024 **për pozitën e Fakultetit Juridik** "Një asistent për lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta administrative, E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese krahasuese, Procedura administrative, E drejta e punës".
- II. Anulohet konkursi i ri-shpallur me nr.prot.2998 i publikuar me dt.21.12.2023 për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë për vitin akademik 2023/2024 **për pozitën e Fakultetit Juridik** "Një asistent për lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta administrative, E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese krahasuese, Procedura administrative, E drejta e punës".
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Anulimi i vendimit të Senatit dhe konkursit të rishpallur sipas pikës I dhe II të përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi bëhet për shkak të konstatimit që nuk është tejkalar afati i përcaktuar me Rregulloren 1670 dt. 28.09.2021, neni 8 pika 1 për pozitën e Fakultetit Juridik, ku nga mungesa e fakteve të prezentuara nga ana e Këshillit të Fakultetit Juridik, Zyra për çështje akademike ka konstatuar se është shkel afati për dorëzim të Raportit Vlerësues për kandidatin më të suksesshëm, mirëpo më pas vet Këshilli i kësaj njësie akademike ka argumentuar se për shkak të dorëheqjes së njërit nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, bazuar në nenin 16 paragrafi 17 i Rregullores 1667 dt.28.09.2021, zgjatet afati i dorëzimit të Raportit Vlerësues edhe për 10 ditë, kështu që nuk ka pasur tejkallim afati.

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kandidatët e pakënaqur mund të hapin kontest pranë Gjykatës kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit Juridik;
3. Zyrës për Çështje Akademike;
4. Zyrës për informim me publikun;

Prof.asoc.dr.Merita Shala

Kryesuese e Senatit

